



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:015668
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05452774

AC-I-23-0199

Në ankesën e

Paditësja/Ankuesja

B K, nga Prishtina, e përfaqësuar nga avokati K B nga Hajvalia.

kundër

E paditura/Ankuesja

NSH. "Auto Prishtina", (në likuidim), Prishtinë, të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. " Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Djellza Hoxha gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses dhe të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-0711 të datës 21 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesat janë të bazuara.**
- 2. Anulohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-0711 i datës 21 mars 2023.**

3. Lënda kthehet në rigjykim në Shkallën e I-rë të DHPGJS, tek gjyqtari përkatës.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 29 prill 2015, paditësja e dorëzon një padi në DHPGJS për pagesën e pagave të mbetura e të pa paguara nga NSH "Auto Prishtina", në Prishtinë. Me këtë padi kërkohet nga Gjykata që të detyrohet e paditura të paguaj borxhin kryesor për paga të pa paguara për periudhën tetor 2003 deri në qershor 2014, në shumë prej 12,480.00 euro, si dhe ka kërkuar kamatën ligjore në vlerë prej 3.5 % për çdo vit. Në këtë padi paditësja nuk cek ndonjë vendim të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në padi paditësja pohon se ajo vazhdimisht i ka kërkuar pagat nga NSH-ja e paditur në bazë të kontratës së punës dhe atë deri në fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së për çka ajo pohon se e ka pranuar një Njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe mundësinë e paraqitjes së kërkesave tek Autoriteti i Likuidimit. Në padi ajo pohon se kishte rezistuar me punëtor të tjerë për uzurpimin e pronës së NSH-së, nga ana e ndërmarrjes private e cila e kishte marrë asetet e NSH-së, me qira, mirëpo as AKP-ja as menagjmenti i NSH-së, dhe as ndërmarrja nuk kanë siguruar funksionim normal të NSH-së, kështu që punëtorët nuk kishin mundësi të punonin pa pengesa për çka punëtorët nuk ndihen fajtor. Bashkë me këtë padi paditësja dorëzon autorizimin e avokatit, kontratën e punës të datës 10.10.2003, një deklaratë drejtuar zyrës rajonale të Prishtinës, fotokopjen e Librezës së punës e hapur me 12.07.1985, e mbyllur me 19.02.1992 dhe përsëri e rihapur por pa vulë të NSH-së, një parashtresë për dorëzimin e autorizimeve për paditë e ushtruara në gjykatë.

Me datë 17 qershor 2021, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në padi. Në mbrojtjen në padi AKP-ja ka pohuar se padia nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë nga neni 70.2 i Shtojcës së LDHP. AKP-ja pohon se paditësja ka dështuar të tregoj se cili nen është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e paditëses është parashkruar pasi që ajo nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi ti ketë kërkuar këto paga brenda 3 viteve e më së

voni nga shtatori i vitit 2003, kur pretendohet se nuk janë paguar pagat nga NSH-ja. Me këtë parashtresë AKP-ja ka dorëzuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN126-0133 të datës 31.03.2015.

Me datë 21 korrik 2021, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe kundërpërgjigjet ndaj mbrojtjes në ankesë ndaj AKP-së. Në këtë parashtresë ajo i përsëritë të njëjtat pretendime të cilat i ka cekur në ankesë ndërsa e kundërshton pretendimin e AKP-së se kërkesa për paga është parashkruar.

Me datë 28 shkurt 2023, përfaqësuesi i ri i paditësit K B e dorëzon një parashtresë në DHPGJS në të cilën njofton se avokati i mëhershëm Sh S ka ndërruar jetë. Në këtë parashtresë ai pohon se gjykata duhet të vazhdojë komunikimin me këtë përfaqësues të paditësit.

Me datë 21 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-0711, e aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke detyruar të paditurën që të paguajë paditëses shumë prej 3,477.96 euro, në emër të diferencës së pagave të mbetura të pa paguara për periudhën korrik 2012 - qershor 2014, si dhe shumë prej 348.00 euro në emër të kamatës së vonesës prej 10% të shumës së detyrimit bazë në shumë totale për pagesë prej 6,992.35 euro, të cilat do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Me pikën e dytë të dispozitivit Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e refuzon pjesën tjetër të kërkesës përtej shumës së aprovuar 3,477.96 euro e deri në shumë e kërkuar prej 12,480.00 euro. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se paditësja ka qenë punëtore e NSH-së "Auto Prishtina" deri në fillimin e procedurës së likuidimit, deri me datën 21.07.2014, kur AKP-ja i ka dërguar njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Nga kontrata e punës vërtetohet se lartësia e pagës bruto ka qenë në shumë prej 181.61 euro. Paditësja me parashtresën e datës 21.07.2021 ka pohuar se gjatë periudhës kontestuese ka pranuar një akontacion në vend të pagës në shumë prej 85 euro. Pastaj paditësja ka paraqitur kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit për pagesën e pagave të mbetura të pa paguara që i takojnë periudhës tetor 2003 – qershor 2014, e cila është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit se kërkesa është parashkruar. Tutje Shkalla e I -rë konstaton se faktet vendimtare të rastit nuk janë kontestuese,

mirëpo refuzimi i kërkesës duke u mbështetur vetëm në një argument ligjor, institutin e parashkrimit nuk është vendim i drejtë pasi që kërkesat për pagesën e këtyre pagave nuk është parashkruar për periudhën nga korrik 2011 deri në qershor 2014, marrë për bazë faktin që marrëdhënia e punës është pushuar me datë 21.07.2014. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës për tri vitet paraprake, nga muaji korrik 2011 e deri më qershor 2014. Andaj duke marrë për bazë faktin se paditësi në bazë të kontratës së punës e kishte pagën 181.61 euro e duke marrë për bazë akontacionin e paguar prej 85 euro në muaj, obligimi për pagat e pa paguara është zbritur në shumën prej 96.61 euro e që për tridhjetë e gjashtë muaj bëjnë gjithsej 3,477.96 euro. Paditësit po ashtu bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së i është njohur edhe interesi ligjor në borxhin e shumës së pranuar prej 10%. Pjesa tjetër e kërkesës është refuzuar ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit.

Me datë 05 prill 2023, paditësja përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-15-0711 të datës 21 mars 2023, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të vërtetohet pika I e dispozitivit ndërsa të priset pika II e dispozitivit dhe çështja të kthehet në rigjykim ose të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses në vlerë prej 12.480.00 euro me kamatë ligjore prej 10%. Për më tepër në ankesë paditësja pohon se borxhi i përgjithshëm i NSH-së në emër të pagave për periudhën 10.10.2003 deri 21.07.2014 është 12.840.00 euro. Tutje paditësi pohon se ishte në marrëdhënie punë në NSH dhe se i ka kryer të gjitha punët të cilat ishin nën përgjegjësinë e saj. Tutje paditësja pohon se sipas nenit 387 të LMD-së parashkrimi ndërpritet kur debitori e pohon borxhin e në këtë rast parashkrimi është ndërprerë nga dhënia e kësteve në emër të pagave të pa paguara në vlerë prej 85 euro, andaj ky fakt vërteton se nuk bëhet fjalë për parashkrim. Tutje paditësja pohon se gjykata e Shkallës së I-rë e ka aprovuar shumën prej 3.477.96 euro duke zbritur nga vlera e pagës 181.60 euro shumën e akontacionit prej 85.00 euro, me ç'rast e aprovon pretendimin se është paguar akontacioni në baza mujore dhe ky fakt vërteton se është ndërprerë parashkrimi për çdo muaj, ndërsa këtë gjë gjykata nuk e përmend

askund. Kontest të kësaj paditësja vlerëson se gjykata është orientuar periudhën e vitit 2011 – 2014, atëherë ka qenë dashur që pagat e paditëses ti llogariten në vlerën e plotë 181.60 euro e të mos i zbres vlerën 85.00 euro në emër të akontacionit të paguar. Për tridhjetë e gjashtë muaj shuma e zbritur prej 85 euro arrin vlerën 3,060 euro e kur ti shtohet edhe vlera e aprovuar prej 3,477.96 euro do të arrinte vlerën prej 6.537.00 euro, duke mos llogaritur edhe kamatën ligjore prej 10%.

Me datë 7 prill 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përmes postës një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-15-0711 të datës 21 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar, ose lënda të kthehet në rishqyrtim. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike, ndërsa është i gabuar konstatimi i Gjykatës së Shkallës së I-rë lidhur me vlerësimin që është dhënë nga Autoriteti i Likuidimit për kërkesën e paditësit. Tutje AKP-ja konsideron se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar pasi që paditësi ka dështuar të ofroj prova në Gjykatë se këto paga i ka kërkuar brenda 3 viteve pranë ndonjë Gjykate kompetente. Tutje AKP-ja pohon se Gjykata ka ngatërruar çështje të rëndësishme faktike dhe rrjedhimisht edhe juridike dhe për pasoj ka bërë vlerësim të gabuar dhe ka marrë Aktgjykim të pa drejtë. AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën si të pa pranueshme sepse paditësi nuk ka arritur të provoj me fakte meritën e kërkesës së tij. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë i ka ngatërruar dy çështje që janë krejtësisht të ndryshme, afatin për dorëzimin e kërkesave në bazë të dëshmisë së interesit në procedurën e likuidimit që është afat për parashtrimin e kërkesave dhe afatin e dytë që ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë e që i referohet pagave të pa paguara (afati i parashkrimit) që është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuara. Të dy afatet janë të ndara dhe të dallueshme dhe secili kreditor i NSH-së duhet ti përmbush këto dy afate në mënyrë që të shqyrtohet kërkesa.

Me datë 8 qershor 2023, paditësja e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësja kundërshton të gjitha pretendimet e AKP-së si të pa bazuara në Ligj, duke pohuar se ajo ishte punëtore e NSH-së deri në ditën e likuidimit të NSH-së. Tutje paditësja pohon se vendimi i ankimuar i Autoritet të Likuidimit është i pa bazuar në Ligj, duke dhënë konstatimin e paqëndrueshëm se gjoja nuk isha punëtor aktiv i NSH-së. Tutje ajo pohon se ky konstatimin kundërshtohet me provat që janë në dosjen e lëndës, kontratën e punës me kohe të pa caktuar , listën e punëtorëve , Librezën e punës. Tendenca për shtrembërimin e provave dhe gjendjes se vërtetuar faktike, nuk është në favor as të paditurës, pasi që AKP-ja duhet të paguaj edhe kamatën përveç pagave, e që kjo shkakton prolongon ende këtë çështje juridike, me faj i të paditurës.

Me datë 16 qershor 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesat janë të bazuara.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesave dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 29 prill 2015, përmes postës e ka dërguar një padi në DHPGJS dhe kërkon paga të pa paguara nga NSH "Auto Prishtina" (në likuidim) Prishtinë, për periudhën nga muaji tetor 2003 e deri qershor 2014, në shumë prej 12,480.00 euro.

Me këtë padi nuk është cekur asnjë vendim i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit as dhe as me padi nuk është dorëzuar ndonjë vendim i Autoritetit të Likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja me mbrojtjen në ankesë të dorëzuar në Shkallën e I-rë me datë 17 qershor 2021 e ka sjellë edhe kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN126-0133 të datës 31 mars 2015, i cili i referohet pagave të pa paguara për periudhën tetor 2003 – qershor 2014, e të cilit vendim paditësja për herë të parë i referohet në parashtresën e datës 21 korrik 2021 e cila dorëzohet si përgjigje ndaj mbrojtjes së AKP-së.

Duke marrë për bazë faktin se kërkesa është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 11 shtator 2014 (ky fakt vërtetohet nga vendimi i Autoritetit të Likuidimit që sillet nga AKP-ja), atëherë del që pagat nga muaji shtator 2011 e deri në muajin qershor 2014, nuk janë parashkruar, pasi që ende nuk ka kaluar afati 3 vite i parashkrimit, ndërsa pagat e tjera të periudhës së cekur janë parashkruar. Shkalla e I-rë ka të drejtë kur konstaton se në këtë periudhë nuk ka parashkrim të kërkesës dhe këtë konstatim e mbështet edhe Kolegji i Apelit.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë në arsyetimin e Aktgjykimit të ankimuar i referohet njoftimit të AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, i cili dokument nuk është në dosjes e Shkallës së I-rë, madje ky dokument nuk ofrohet as me ankesën e paditëses në Shkallën e II-të. Tutje Shkalla e I-rë në arsyetimin e Aktgjykimit të ankimuar konstaton se paditësi ka punuar në NSH deri në ditën e

likuidimit të NSH-së me datë 21.07.2014, dhe nuk është e qartë se në cilën provë e mbështet këtë konstatim. Padiësi është fakt që e ka sjellë kopjen e Librezës së punës, e cila NSH "Auto Prishtina" është hapur 12.07.1985 dhe është mbyllur me 19.02.1992, ndërsa në tabelën vijuese të kësaj Libreze është mbishkrimi "Auto Prishtina", Prishtinë, ndërsa nuk ka as datë të rihapjes dhe as datë të mbylljes, madje nuk ka as vulë të NSH-së. Padiësi me ankesën e tij në Shkallë të I-rë e ka sjellë një kopje të kontratës së punës nga e cila shihet se paga e padiësit me datës 10 tetor 2003 ishte 181.61 euro, por kjo provë nuk flet për lartësinë e pagës për periudhën prej korrik 2011 – qershor 2014, kur për këtë periudhë kërkesa për paga ende nuk është parashkruar. Në dosje nuk ka asnjë listë të pagave për të vërtetuar lartësinë e pagës mujore të padiëses, për periudhën për të cilën kërkesa ende nuk është parashkruar. Kolegji i Apelit vëren se edhe dispozitivi i Aktgjykimit në pikën I nuk është shumë i qartë, ku thuhet se është aprovuar shuma prej 3,477.96 euro në emër të diferencës së pagave të pa paguara për periudhën korrik 2012 – qershor 2014 si dhe shuma prej 348.00 euro në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës së detyrimit bazë 6.992.35 euro, që për Kolegjin e Apelit mbetet e paqartë se cila shumë në fakt është aprovuar për palën padiëse në emër të pagave të pa paguara për periudhën e cekur.

Tutje Kolegji i Apelit nuk e mbështet pretendimin e AKP-së kërkesa për paga tërësisht është parashkruar, kjo për faktin që në bazë të vendimit të Autoritetit të Likuidimit që u cek më lartë e të cilën vet AKP-ja e ka sjellë në gjykatë shihet se padiësi kërkesën për paga për periudhën tetor 2003 - qershor 2014 e ka paraqitur tek Autoriteti i Likuidimit me 11 shtator 2014, që do të thotë pagat nga shtator 2011 e deri me qershor 2014 nuk mund të konsiderohen të parashkruara.

Kolegji i Apelit konstaton se në këtë rast nuk është ndërprerë parashkrimi i kërkesës, edhe pse NSH-ja siç pohon padiësi, punëtorëve u ka paguar nga 85 euro, në emër të akontacionit të pagës. Padiësi ka pas interes që për pjesën e papaguar të pagës mujore, të mos lejoj të rrjedhë parashkrimi i kërkesës, i cili ka filluar të rrjedhë prej ditës kur ka lindë detyrimi mujor i NSH-së, që në baza mujore në periudhën e cekur të paguaj pagën e tërësishme të tij, në bazë të Kontratës së punës.

Paditësi është e qartë se kërkesën për paga e ka parashtruar vetëm me datë 11 shtator 2014, tek Autoriteti i Likuidimit, e jo edhe më herët në gjykatën kompetente.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij në Shkallën e I-rë dhe me parashtrësat e më vonshme të tij ka pohuar që vazhdimisht i ka kërkuar pagat prej NSH-së në periudhën e cekur, mirëpo ato nuk janë paguar. Nëse kjo ka ndodhë, paditësi e ka pas mundësin që të paraqesë padi në gjykatë, e të mos lejoj rrjedhjen e parashkrimit të kërkesës. Nuk ka prova se paditësi e ka kërkuar diferencën e pagave në afatin prej tri viteve në gjykatën kompetente, andaj për një pjesë të periudhës kërkesa është parashkruar.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se asetet e NSH-së "Auto Prishtina" në vitin 2000, nga autoritetet e UNMIK-ut ishin dhënë me qira një kompanie private. Paditësi nuk është e qartë nëse ka punuar në këtë kompani private që i kishte marrë asetet e NSH-së me qira.

Është edhe një çështje, që në fakt asetet e NSH-së janë marrë me qira nga, SH. A "Auto Prishtina", por nuk ka të dhëna deri në cilin vite kjo kompani i ka pas në shfrytëzim këto asete, dhe duhet të vendoset nëse NSH-ja ka përgjegjësi kontraktuale për pagesën e pagave të punëtorëve, për periudhën kur SH. A "Auto Prishtina", i kishte në shfrytëzim këto asete të kësaj NSH-je, e cila gjë ka mbetur e pa adresuar.

Rrjedhimisht duke marrë për bazë faktin që pagat e kërkuara nga muaji tetor 2011 e deri në qershor 2014, ende nuk janë parashkruar, Kolegji i Apelit konstaton se në këtë çështje juridike nuk është vendosur drejtë, pasi që ende saktësisht nuk është vërtetuar as gjendja faktike.

Prandaj duke u bazuar në gjendjen e cekur faktike, Kolegji i Apelit konsideron se ankesat e dy palëve janë të bazuara, dhe lënda duhet të kthehet në rishqyrtim që të vërtetohen faktet që mbeten kontestuese në mes të palëve, dhe pastaj pas

provave të reja që duhen të administrohen, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së duhet të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Prandaj nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 05 qershor 2023, në shumë prej 100 euro, ndërsa paditësja me datë 26 maj 2023, në shumë prej 30 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendosë nga Kolegji i Apelit me 14 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____